



**Komuna e Mitrovicës Veriore**  
Opština Mitrovica Sever – Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës.

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 09/08/2024.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, nenit 59.1 të Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, në bashkëpunim me zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit, Kryetari i Komunës sjell këtë:

**V E N D I M**

**(Për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në Procesin e Tenderit “Furnizim me Kompiuter Brand Name ALL in One dhe Laptop” me Nr. Prokurimit 647-24-7918-5-5-8.)**

1. **Formohet** Komisioni për Vlerësimin e Ofertave në Procesin e Tenderit me Nr. Prokurimit 647-24-7918-5-5-8, në këtë përbërje:
  - 1.1 [REDACTED] – kryesues, D.A.P.;
  - 1.2 [REDACTED] – anëtar, D.K.R.S.;
  - 1.3 [REDACTED] – anëtare, D.B.F.
2. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi, është i obliguar të bëjë vlerësimin e ofertave në Procesin e Tenderit me Nr. Prokurimit 647-24-7918-5-5-8.
3. Komisioni, vlerësimin e ofertave e bënë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe dispozitat përkatëse nënligjore.
4. Komisioni duhet të hartojë Raport me Shkrim dhe të dorëzojë pranë Zyrës së Prokurimit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore**

**I dorëzohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë/Njësia kërkuese
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit